

RAPORT NGA KAMPI VEROR PËR FËMIJË ULQINI 2007 NGA DATA 26/08-07/09/2007



Mbështetur dhe financuar nga *ONLUS R.BAZONI*
Implementuar nga *HANDIKOS*

Hyrje:

Sikur edhe gjashtë viteve të mëparshme, organizimi i kampit, struktura e fëmijëve dhe përcjellësve të tyre është bërë në mënyrë të njëjtë nga të gjitha Qendrat e RBB`së HandiKOS`it

Për dallim nga kampet e mëhershme, këtë vit kemi arritur që në ekip të punëtorëve të kemi një psikologe e cila ka qenë e nevojshme dhe arsyeshme duke u bazuar nga takimet që kemi pasur më herët me nënat e fëmijëve dhe është vlerësuar shumë pozitive pjesëmarrja e saj në këtë kamp.

Gjithashtu duhet përmendur që këtë vit kemi arritur të kemi në kamp një ekip televiziv nga Radio Televizioni i Kosovës të cilët kanë përcjellë aktivitetet e të tri grupeve që janë realizuar në kamp dhe kanë përgatitur një emision dokumentar është i cili emetuar pas dy javëve në Mediumin Publik të Kosovës, më datën 22 shtator në ora 23.15. Ky emision është bërë në kohëzgjatje prej 22 minutave.

Pjesëmarrësit – 51 persona

23 fëmijë dhe 23 përcjellëse, si dhe

4 punëtorë nga HandiKOS-i, dhe një psikologe

Gjinia: 13 vajza dhe 10 djem

Përcjellësit: 15 nëna

3 gjyshe

2 halla

2 motra

1 teze

Aftësitë e kufizuara të fëmijëve/Diagnozat:

6 fëmijë me Paralizë Cerebrale

8 fëmijë me Hemiparezë

3 fëmijë me Sindrom Down

1 fëmijë me Arthrogyrosis

2 fëmijë me LCC

1 fëmijë me Hidrocefalus

1 fëmijë me PEV- Hypotonia

1 fëmijë me Paralysis plexus Brachialis



Ekipi nga HandiKOS`i si dhe përgjegjës të tyre :

Dr. Ziza Gashi – Mjeko dhe përgjegjëse e kampit

Shpresa Namani – Koordinatore e aktiviteteve dhe punëtoreshë rehabilitimit primar fizik

Elfije Kelmendi – Edukatore e aktiviteteve zhvillimore/psiko-motorike

Mimoza Sefaj – Punëtoreshë rehabilitimit primar fizik

Alberina Hamiti - Psikologe



Nga të gjithë fëmijët që ishin pjesëmarrës në kamp, 4 prej tyre gjatë vitit të kaluar kanë pasur operime të cilët janë referuar nga Qendrat e HandiKOS`it.

Transporti: Është bërë nga agjencia turistike "Lindi Tours" (autobus).

VENDI: Ulqin Hotel „ FLORIDA”, plazhi i vogël.

Arsyeja e zgjedhjes së vendit të njëjtë që disa vite, është se ky Hotel i plotëson kushtet për fëmijët dhe aktivitetet që realizohen aty si dhe afërsia me plazhin por edhe mikpritja dhe përkrahja e pronarit të Hotelit dhe personelit.

Udhëtimi – Nisja nga Prishtina është bërë në ora 21:00 me datën 26/08/07 arritja në Ulqin në ora 08:00 me datën 27/08/07 ndërsa kthimi është bërë me datën 06/09/07 kurse arritja në Prishtinë me datën 07/09/07 në ora 05/30.

Dita e parë dhe prezantimi në mbrëmje – Pas arritjes dhe akomodimit të fëmijëve dhe përcjellësve në Hotel si dhe pushimit të tyre, në mbrëmjen e parë është bërë prezantimi i qëllimit të kampit, orarit të aktiviteteve, pjesëmarrësve si dhe personelit nga HandiKOS`i.

Po këtë mbrëmje është prezantuar fondacioni ONLUS R.BAZZONI i cili ka qenë mbështetës i kampeve që 7 vite si dhe ndihma dhe përkrahja edhe në aktivitetet e tjera të HandiKOS`it, i cili kontribut është çmuar shumë nga të gjithë pjesëmarrësit. Gjatë kësaj mbrëmje është dhënë edhe një historik i shkurtër mbi HANDIKOS`in, shërbimet që ofrohen nëpër qendrat e RBB` së për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara si dhe aktivitetet tjera që realizohen.



Sikur edhe viteve të mëparshme, nga personeli i HandiKOS`it ishte përgatitur për çdo fëmijë nga një dhuratë për djem dhe vajza (vajzave nga një çantë me nga një kukull, ndërsa për djemtë nga një çantë me lodra tjera). Pastaj u janë shpërndarë maicat me mbishkrimin e: donatorit R. BAZZONI, logon e HandiKOS`it si dhe në to ka qenë i shtypur emri doktoreshës Julia Palao, në shenjë respekti për kontributin që ka dhënë për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Në këtë mbrëmje është bërë edhe shpërndarja e të hollave të cilat kanë qenë të planifikuara për fëmijët si shkak i kushteve të rënda ekonomike si dhe një përkrahjeje nga donatori.

Aktivitetet

Mëngjesi – Në aktivitetet e mëngjesit fëmijët kanë qenë të ndarë në dy grupe Grupi A dhe Grupi B, ku njëri grup ka mbajtur aktivitetet e rehabilitimit fizik (fizioterapi) kurse tjetri aktivitetet psiko-motorike dhe anasjelltas.

Aktivitetet e rehabilitimit fizik (Fizioterapisë) – Kryesisht është punuar

fizioterapi aktive dhe pasive, duke u bazuar në programin e RBB` së, që implementohet nëpër qendrat e HandiKOS` it si dhe vazhdimësinë dhe përcjelljen e këtyre aktiviteteve nga nënat dhe përcjellëset e tyre. Gjatë këtyre ditëve, nenave ju kemi referuar që të punojnë sa më shumë në pavarësinë e fëmijëve meqenëse edhe ky kamp kishte qëllimin e njëjtë.



Aktivitetet Psiko-motorike-gjatë këtyre dhjetë ditëve është bërë punë intensive me fëmijë por edhe me nënat e tyre, duke filluar nga stimulimi i tyre si dhe gjetja e mënyrave më të mira për tejkalimin e vështirësive që kanë fëmijët në jetën e tyre të përditshme. Aktivitetet që janë realizuar gjatë këtyre ditëve kanë qenë: përdorimi i lapsit, ngjyrosje, punimi me plastelin, vizatim, formimi i figurave në letrat me ngjyre, punimi i zarfeve si dhe aktivitete tjera .



Plazhi – aktivitetet në plazh janë organizuar çdo ditë duke filluar nga ora 10 deri në kohën e drekës dhe pas dreke nga ora 14 deri në 17.30.

Gjatë kësaj kohe në plazh, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme si loja me rërë, noti, loja me litar, hokej, parachuta, loja me thasë zalli etj. Po ashtu përveç aktiviteteve që kanë qenë në orar janë mbajtur edhe lojëra tjera të ndryshme si loja me top në ujë, ushtrime në ujë, vallëzimi në formë të trenit etj.

Udhëtimi me anije- ndër aktivitetet e shumta që janë realizuar gjatë këtyre ditëve, ka qenë edhe udhëtimi me anije nga plazhi i vogël deri te plazhi i madh. Ky udhëtim ka qenë i veçantë meqenëse asnjë nga fëmijët dhe nënat e tyre nuk kishin përjetuar një kënaqësi të tillë dhe për ta ishte një përjetim i rrallë.

Dalja në qytet – Shumë nga nënat dhe fëmijët deri më tani kishin qenë të mbyllur dhe nuk kishin pasur rast që ta dalin në qytetet e tyre dhe dalja në qytetin e Ulqinit ishte një rast që ato të fillojnë ti thyejnë komplekset që ishin si paragjykim i shoqërisë ndaj tyre.

Aktivitetet e mbrëmjes – Gjatë mbrëmjeve janë organizuar edhe aktivitete tjera të ndryshme, si ajo e hapjes solemne, nata ku fëmijët kanë recituar, kënduar dhe vallëzuar e që për disa fëmijë ishte hera e parë që dilnin para publikut. Po ashtu edhe nga organizimi i aktiviteteve të ndryshme nga nënat si Show, maskemball etj. Në këtë kamp një fëmijë, Shpresa Hashani kishte ditëlindjen dhe të gjitha nënat u organizuan dhe i festuan ditëlindjen Shpresës e cila ishte tejet e gëzuar e sidomos kur asaj iu përgatitë një torte nga një mysafir (turist) nga Kosova si dhe disa dhuratave që asaj iu dhuruan atë natë nga vet nënat. Po ashtu kishte edhe organizime tjera nga nënat dhe fëmijët e tyre si: pjesë teatrale, imitime të ndryshme etj.



Për të ditur se sa janë nënat e informuara mbi aftësitë e kufizuara të fëmijëve të tyre, janë organizuar edhe kuize me ç`rast janë formuluar pyetje që kanë pasur të bëjnë me diagnozat, vështirësitë e tyre të përditshme si dhe pasojat. Gjithashtu janë mbajtur edhe për pesë ditë ligjërime mbi diagnoza të ndryshme si: down syndrom, paraliza cerebrale por edhe mbi të drejtat e fëmijëve.

Në një rën prej netëve të pas darkës, është bërë edhe zbulimi i ekspozitës me punime nga plastelini të skanuara (ngjitura) në fletë të bardhë të punuara nga fëmijët. Ishte një punë sa interesante po aq atraktive, për të zbuluar talentin e fëmijëve dëshirën për pjesëmarrje në aktivitet dhe njëkohësisht dëshirën për jetë.



Party- Për dallim nga vitet tjera, këtë vit për të tërhequr më shumë vëmendjen fëmijëve në vend të maskave të blera, për çdo fëmijë janë bërë vizatime me dorë dhe ngjyra në fytyrat e tyre që njëkohësisht i kanë bërë vet fëmijët me qëllim që edhe ata duke angazhuar mimikën e tyre t`i japin një performancë më të mirë pamjes së tyre. Është bërë hapja e ekspozitës me ç`rast ka pasur edhe vallëzim, këndim e recitim nga fëmijët e po ashtu edhe nga nënat e tyre.

TAKIMET ME NËNAT: Gjatë qëndrimit në kamp kemi mbajtur 5 ditë takime të veçanta me nënat. Pas diskutimit të secilit rast në veçanti me nënat, sipas aftësive të kufizuara (diagnozave) të fëmijëve, me: Paralysis Cerebralis, Hemiparesis, Polio, RPM, PPB, Sy Down janë dhënë sqarime, këshilla si dhe në takimin e fundit kemi pasur diskutime të lira me të gjitha nënat. Arsyeja e takimeve ishte që nënave t`u ofrohen sa më shumë njohuri rreth aftësive të fëmijëve të tyre, aftësive të fëmijëve, pavarësisht sa më të madh të fëmijëve por edhe puna që vetë nënat mund të bëjnë në përmirësimin e gjendjes së fëmijëve në shtëpi.

Kujdesi Mjekësor – Gjatë këtyre 10 ditëve sa ishim në kamp nuk kemi pasur probleme serioze shëndetësore me fëmijë, përveç atyre më të shpeshta: temperatura, barkë qitje, dhimbje (dhëmbi, barku, koke etj), por edhe problemet me tension të nënave. Por të gjitha këto probleme shëndetësore është

përkujdesur doktoresha me njohuritë e saja por gjithashtu ndihma ka qenë në pajisjet mjekësore me të cilat posedonim gjatë qëndrimit në kamp. Kështu që nga doktoresha është preferuar që çdo mëngjes çdo fëmijë t' u jepen vitamina C, në mënyrë që fëmijëve t' u shtohet imuniteti dhe të parandalohet çdo sëmundje apo virus.

Vlerësim nga psikologja

Sikur u përmend në fillim, në këtë kamp ka qenë e angazhuar edhe një psikologe e cila ka marrë pjesë në mënyre vullnetare.

Gjatë qëndrimit sa ishim në kamp është vlerësuar shume pjesëmarrja e saj e cila përmes takimeve me nëna dhe fëmijë ka vlerësuar se çdo nënë dhe fëmijë ka nevojë për përkrahje emocionale. Gjatë takimeve të përbashkëta me nëna, është vërejtur së nënat nuk janë shprehur në mënyrë të lirshme në prezencën e nënave tjera, arsyeja qëndron në faktin se ato ishin të pasigurta në vetvete dhe e gjithë kjo ishte pasojë e krijuar me vite nga trajtimet e shoqërisë por edhe të familjeve të tyre. Kjo gjendje vërehej sidomos të nënat që vinin nga viset rurale dhe ato që kishin vështirësi më të mëdha ekonomike. Mirëpo në takimet e 'rastësishme' individuale më nënat, ato shpreheshin shumë më lirshëm dhe tregonin për vështirësitë e tyre të përditshme me ç' rast vërehej se ato fillonin ti thyenin paragjykimet dhe komplekset. Duhet përmendur rasti i nënës Bahrije Abazi e cila gjatë një takimit të 'rastësishëm' nga brengat dhe vuajtjet e saj gjatë bisedës dhe duke treguar për peripecitë e saja, ajo filloi të qante gjë të cilën nuk mund ta bënte në prezencën e nënave tjera.

Po ashtu te disa nëna është vërejtur 'varësia' e madhe dhe ndikimin e nënave te fëmijët e tyre. Njëri prej fëmijëve ka qenë e varur ne aspektin emocional, varësi, kufizim dhe imponimin nga nëna e saj e cila si pasojë ka sjellë fëmijën që ajo të jetë një kopje e personalitetit të nënës së saj e jo të jetë e vetvetja. Pas disa bisedave me nënën e po ashtu edhe me fëmijën vërehej se ajo fillonte të kishte një siguri më të madhe në vetvete por edhe "varësia" e saj nga nëna ishte më e vogël. Ky rezultat ka qenë edhe në faktin e ndikimit të gjitha aktiviteteve të cilat u organizuan gjatë kampit.

Rezultatet-

Te gjithë fëmijët pas përpjekjeve me kënaqësi e kane pranuar ujin dhe socializmin me fëmijët tjetër. Shumë prej tyre filluan të ushqehen vetë, të vishen dhe zhvishen vetë, e deri te recitimet para tjerëve për të cilat deri më tani kishin hezitur shumë.



Përshtypjet nga nënat dhe fëmijët

- Bamirësia juaj na bëri të lumtur!
- Përhëndetje e veçante R.Bazzoni nga fëmijët me aftësi të kufizuara të Kosovës
- Emri Bazzoni do të jete gjithmonë në kujtesën tonë
- Ishte hera e parë që e ndjeva veten të barabartë me fëmijët tjerë
- Dhashtë zoti të ketë njerëz të mirë si ju Zt.Bazzoni-
- Momenti më i vështirë është të përjetosh ndarjen kur kalon aq bukur dhe të kesh një përkujdesje aq të madhe
- Përkujdesja e madhe së stafit të Handikosit na ka bërë të lumtur për këto ditë
- Zoti i shpërbleftë ata që mendojnë dhe kontribuojnë për fëmijët tonë.

Fjalët e një nëne:

Citojë „Të mendoj dhe të shkruaj për kampin e Ulqinit më bën nderë dhe më pikëllon. Me bën nder,sepse ende ka njerëz të cilët mendojnë për këtë kategori fëmijësh andaj në emrin tim personal dhe familjar i falënderoj të gjithë për kontributin që dhanë,ndërsa më pikëllon sepse vështirë qenka të përjetosh ndarjen kur kalon aq bukur dhe ke përkujdesje aq të madhe”

ZIZA GASHI
SHPRESA NAMANI
ELFIJE KELMENDI
MIMOZA SEFAJ
ALBERINA HAMITI

Prishtine 2007